

PINA VATA

GJURMË TË MUNDSHME ILIRE NË ETNONIMIN “SHQIPTAR”

Abstrakt

Studiuesit e huaj kanë arritur në përfundime që shpesh nuk konvergojnë, por që sjellin të dhëna që mund vërtetojnë hipotezat e ngritura për lidhjen e etnonimit “shqiptar” me lashtësinë ilire të vetë popullit që e mbart këtë emër. Për të arritur në rezultate të kënaqshme duhet të shfrytëzojmë të gjitha burimet e mundshme. Arkeologjia përmes trashëgimisë materiale na ofron të dhëna që vërtetojnë vjetërsinë edhe origjinën ilire të shqiptarëve. Duke përdorur të dhënat e arkeologjisë, historisë, studimet e albanologëve shqiptarë dhe të huaj dhe duke studiuar të folurën e banorëve të zonave më të thella të Shqipërisë mund të provojmë të hedhim hipotezën se emri “shqiptar” ka në rrënjë fjalën paraindoeuropiane *skei*, që gjendet në fjalorin e vjetër të gjuhëve gjermanike, por me origjinë të panjohur dhe që ka pushuar së qeni në këto gjuhë ndërsa në shqip vazhdon të përdoret edhe sot; dhe si në gjuhët indoevropiane edhe në shqip shënon konceptin e drurit të prerë. Rrënja e mundshme *skei* e fjalës *shqiptar* njihet nga studiuesit e huaj si fjalë burimore shqipe, ndërkohë që e njëjta rrënjë gjendet edhe tek patronimet *Schivipudar*, *Schepuder*. Kjo fjalë i nënshtrohet rregullave të fjalëformimit të gjuhës shqipe, por edhe përligjet historikisht si e mundshme për të zëvendësuar emrin *arbër*, të njohur si emri zyrtar i shqiptarëve në mesjetë.

Fjalë kyçe: shqiptar, Schivipudar, Schepuder, skei, shqyej, fjalë alpine ilire.

Metodologjia

Përmes deduksionit nisemi nga fjala drejt rrënjës së saj. Në mungesë të teksteve të shkruara duhet të nisemi nga raste dhe nga fakte të veçanta për të arritur në një përfundim të ri për origjinën e gjuhës shqipe.

Shfrytëzimi i fjalorëve të ndryshëm dhe ballafaqimi i të dhënave.

Shfrytëzimi i gjithë burimeve të mundshme librore dhe elektronike

Hyrje

Emri “shqiptar” është produkt i kohëve të largëta dhe i shumë faktorëve historikë, socialë dhe gjuhësorë. Për të kërkuar dhe arritur një rezultat të pranueshëm duhen marrë parasysh të gjitha faktet që dalin dhe të gjitha burimet që konsiderohen të besueshme, por në mungesë të dokumentit gjuhësor duhet të përdorim të dhëna të tërthorta.

Shumë studiues të huaj dhe shqiptarë janë përballur me këtë problem dhe janë gjendur përballë vështirësisë që sjell mungesa e dokumenteve të shkruara, por ata sjellin të dhëna që përligjin origjinën paraindoevropiane të emrit *shqiptar*. Duke u nisur nga emri i sotëm arrijmë në një patronim të lashtë që

është dokumentuar në shekullin XVIII, ndërsa rrënja e mundshme fjalës dokumentohet shumë më parë si indoevropiane.

Burimet e huaja na sjellin të dhëna për praninë e një emri të ngjashëm me fjalën “shqiptar” që pasqyron ndryshime fonetike karakteristike për shqipen, ndërkohë që rrënja e kësaj fjale “*skei*” është forma e dikurshme e fjalës “*shqyej*”, fjalë e leksikut të shqipes që përdoret edhe sot në të gjitha trojet shqiptare. Këtë element e ka diktuar edhe Çabej i cili pranon që paralelisht me emrin “arbër” si emër etnik ka shtrirë fushën e përdorimit edhe emri “shqiptar”.

Zhvillimi

Në kushtet e reja historike, sociale dhe kulturore kërkimi në historinë tonë të lashtë mund të intensifikohet duke shfrytëzuar burimet e reja që krijon zhvillimi dhe teknologjia.

Gjuhësia jonë historike, në kushtet e mungesës së dokumenteve të shkruara në gjuhën shqipe edhe të arkivave të mirëfillta si ato perëndimore, ka ecur duke shfrytëzuar të dhënat që burojnë nga shkencat e tjera, dëshmi të gjetura nëpër bibliotekat e huaja, por më së shumti në kushtet e mungesës së teksteve të vjetra të shkruara, rruga më e sigurtë mbetet toponimia jonë, si pjesë e trashëgimisë që ka mbetur dhe vazhdon të na përcillet edhe sot. Po si ka ndryshuar onomastika jonë? Si në të gjithë botën edhe në territorin tonë shumë toponime apo oronime e kanë origjinën në patronime. Kjo është lehtësisht e vërtetuar nëpërmjet toponimeve të kohës së sotme.

Këtu duhet të provojmë të fillojmë kërkimin mbi origjinën e emrit “shqiptar” si një nga rrugët e zakonshme të formimit të emrit të vendit dhe banorëve të tij mbi një patronim. Nëpër të tilla rrugë duhet kërkuar edhe origjina e shqiptarëve, për të gjetur atë shkëputjen iliro-shqiptare, mbase edhe atë pellazgo-shqiptare. Kjo përforcohet edhe më shumë, kur i referohemi mendimit të korifenjve të studimit të historisë së gjuhës shqipe, si Çabej i cili në një artikull të vitit 1972, të publikuar pas botimit të dokumenteve të mesjetës në “Acta Albania” të Shuflait e Jireçekut, nga shek XIV, ku del emri i familjes Schivipudar, Schepuder, Schapudar, Scapuder, të një banori të qytetit të Drishtit afër Shkodrës që përmendet rreth vjetëve 1368-1402 në arkivat e Raguzës, është shprehur se një hipotezë e tillë meriton të gjurmohet më tej, duke pasur parasysh pikërisht këtë fakt.

Po në këtë artikull Çabej shkruan: “Përsa i takon emrit shqiptar, Shqipëri, Shqipni, prej nga ka dalë edhe folja *shqipëroj*, *shqipëlloj*, *spiegoj*, *sqaroj* e gjuhës popullore, ky emër mbetet me burim të dyshimtë. Mendohet që të ketë dalë nga emri i shqipes duke pasur pra shqiptarët emrin e tyre prej këtij shpendi, qysh në kohën e Skënderbeut, duke e vënë në lidhje më anë tjetër këtë emërtim me fjalët e Plutarkut, që Pirroja pas fitores që korri mbi makedonët u kremtua me epitetin shqiponjë, nuk duket t’i rezistojë kritikës, po të nisemi nga trajtat e këtyre dy emrave. Në të vërtetë, tek autorët e vjetër shqiptarë *shqip* shkruar në këtë trajtë dallohet, dukshëm nga emri i shpendit,

që shkruhet tek ata rregullisht *shqype*, gjë që tregon se kemi të bëjmë me dy fjalë të ndryshme. Jo bindës paraqitet edhe afrimi me “*qipi*” mullar bari, me paravendim presupozim të një kuptimi të hershëm *grumbull*, *popull*. Të dyshimta mbeten dhe interpretimet e tjera të këtij emri, ai si “*banor shkrepash e malesh*” dhe ai si “*pushkatar*” prej greqishtes së re “*skipeetton*” pushkë kjo prej italishtes “*schioppetto*”, një fjalë që dëshmohet për greqishten së pari në shekullin XVI-XVII. Shumë i diskutueshëm mbetet më në fund edhe shpjegimi i fjalës *shqip* nga latinishtja *excipio*, siç është pranuar deri tani; fjala latine nuk do të thotë kuptoj siç është shpjeguar, *por marr, vë mënjanë, përjashtoj, pranoj*¹.

Të rikthehemi dhe të ndalojmë në rrënjën e fjalës *Schivipudar*, *Schepuder*, *Schapudar*, *Scapuder*, e nëpërmjet krahasimit arrijmë në përfundimin se rrënja e kësaj fjale lidhet me një fjalë të dokumentuar si fjalë e familjes së gjuhëve gjermanike prej nga kanë rrjedhur në gjuhët përkatëse fjalë që kanë të bëjnë me mjetet e lundrimit, por fjala rrënjë *ske(i)-p* që në gjermanishten e vjetër përkthehet: *pemë e prerë nga jashtë ose e gërryer nga brenda*, është zhdukur.

Sipas fjalorit etimologjik të gjuhës angleze për origjinën e emërtimeve bazë të mjeteve të lundrimit kemi:

Old English *scip* “ship, boat”, from Proto-Germanic *skipam (cf. Old Norse, Old Saxon, Gothic *skip*, Danish *skib*, Swedish *skepp*, Middle Dutch *scip*, Dutch *schip*, Old High German *skif*, German *Schiff*), “Germanic noun of obscure origin” [watkins]. Others suggest perhaps originally “tree cut out or hollowed out”, and derive it from PIE root *skei- “to cut, split”.

Old English *scip* “anije, anije”, nga proto-gjermanishtja * skipam (skandinavishtja dhe sanksionishtja e vjetër, gotikja - *skip*, danisht *skib* –, suedeze - *skepp*- holandisht - *schip*, Old High gjermanisht - *skif*, gjermanisht-*schiff*). Të tjerë sugjerojnë ndoshta fillimisht ka qenë “pemë e prerë nga jashtë (e latuar) ose e gërryer nga brenda” dhe nxjerrin atë nga rrënja paraindoevropiane *skei-* “për të prerë, ndarë”.

Në të dhënat e mësipërme duhet të nënvizojmë faktin që kjo fjalë gjendet në gjermanishten e vjetër si fjalë paraindoevropiane me origjinë të panjohur.

Në të gjitha gjuhët e mësipërme kjo fjalë humbi dhe u zëvendësua nga fjala *rip*- fjalë që e gjejmë edhe në gjuhën shqipe si *rrjep*, por në gjuhën shqipe gjejmë edhe fjalën *shqyej* me një diferencë kuptimore të konsiderueshme: *rrjep* përdoret për të dhënë kuptimin e drejtpërdrejtë heq lëkurën e një druri a një kafshe, ndërsa *shqyej* përdoret për të dhënë kuptimin e çarjes, depërtimit të thellë zakonisht në dru.

Duke ndjekur këshillën e gjuhëtarit të njohur, Selman Riza që thotë se: “Gjuha e folur, “popullorçja” është një element që duhet të përfshihet patjetër në studimin e historisë së gjuhës së një populli, dhe sidomos të shqipes që

¹ *Shqipëria e re*, Nr.1, 1972 Viti XXVI.

është një gjuhë e shkruar relativisht vonë.”² (emrat në gjuhën shqipe nuk mund të lëmë të na shpëtojë fakti që: rrënja skei – na sjell në mendje fjalën shqipe shqeyj, - shqeyj, por që në shumë zona kjo fjalë ka mbetur në shkallën *shkje~shqeu* (qiellzorizimi është i mëvonshëm). *Diftongu indoeuropian /ei/ ka dhënë /e/β në gjuhën shqipe.*)

Kësaj hipoteze i shtojmë edhe një të dhënë të sjellë nga Plotti sipas të cilit fjala dak *skiare* është me origjinë shqipe dhe nga shqipja ka hyrë në trakisht dhe ka dhënë fjalën “gjëmbaç” që ka të bëjë me shqipen *shqerr, shkjerr, shjtjerr*. Pra një fjalë ose parailire, ose shumë e përdorur ilire që trakët e huazuan prej ilirëve. Po të mbledhim dhe të përballim faktet e mësipërme mund të konstatojmë se fjala *skei* është:

1-një fjalë që dokumentohet në gjuhët gjermanike në një periudhë të caktuar historike, por me origjinë të panjohur, dhe kjo duhet theksuar.

2- një fjalë që njihet edhe nga studiuesit e huaj si e burimit shqip dhe që ka depërtuar edhe në trakisht.

3- një fjalë që përdoret edhe sot e kësaj dite në shqipe e që ka krijuar edhe një fushë të plotë leksikore.

Po t’i referohemi fjalës shqiptar gjejmë tipare specifike të fjalëformimit në gjuhën shqipe. Vetë prapashtesa – *tar* është një prapashtesë tipike e shqipes: me prapashtesat – ar, -tar, -or, -tor, etj. formohen emra të përgjithshëm njerëzish të karakterizuar sipas veprimit që kryejnë, sipas një tipari të tyre, mjeshtërisë që ushtrojnë, po ashtu edhe sipas vendit ku banojnë, ose ku kanë lindur⁴. Shndërrimi i -s në -sh është një rregull i ndryshimeve fonetike të shqipes, ndërsa -p e shurdhët përdoret në gjuhën shqipe me funksionin epentetik⁵.

Siç e theksuam edhe më lart, në kushtet kur të dhënat gjuhësore mund të jenë shumë të diskutueshme, arkeologjia me zbulimet e saj materiale na vjen në ndihmë. Duhet të ndalojmë pikërisht në këtë fushë për të qartësuar disa elemente që mund të sqarojnë hipotezat gjuhësore.

Këtë rrugë na sugjeron të ndjekim për studimin e shqipes edhe Çabej, kur shkruan që: “Dija gjuhësore në bashkëpunim me arkeologjinë na paraqesin një shtrirje të gjerë të fiseve ilire në periudhën prehistorike. Sipas studiuesve të huaj kultura e Hallstattit në Tirol të Austrisë, që i përket periudhës së bronzit, ka shumë të ngjarë të ketë qenë kulturë ilire e përzier me kelte. Përhapja e ilirëve në Europën veriore e verilindore, mbi dëshminë e toponimisë ka marrë tipare konkrete aq sa ndonjë studiues si Max Vasmari flet për ilirët veriorë në ato anë e Ilirët jugorë të Ballkanit e të Italisë. Gjurmët ilire në viset e Polonisë

² S. Riza. *Sistemi i rasave dhe tipat e lakimit*, Tiranë, 1965.

³ K. Topalli, *Bazat e fonetikës historike të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005, f. 60.

⁴ *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, AShSh, f. 134, Tiranë, 2002.

⁵ K. Topalli. *Dukuritë fonetike të sistemit të bashkëtingëlloreve të gjuhës shqipe*. Tiranë, 2004 f. 96.

në ato kohë të lashta i kanë diktuar dijetarët polakë Rozvadovski dhe Czekanovski. Norbert Jokli përdor edhe termin “fjalë alpine ilire”⁶.

Sipas Çabejt: “Nga gjithë kjo përhapje që patën, dikur, Ilirët gjatë historisë së tyre erdhën e rrudhën dalëngadalë. Ata u asimiluan me kohë prej popujve të tjerë; në Veri u keltizuan e u gjermanizuan, në Jug u romanizuan, u greqizuan e u sllavizuan dhe vetëm në trevat ku flitet sot shqipja jeton mbeturina e tyre e fundit.”

Pra një popull i tërë me një histori të madhe nëpër shekuj nuk mund të zhduket lehtësisht, por flasim për një kohë shumë më të hershme dhe duhet se duhet të ndalojmë pikërisht në këtë duke kërkuar ndihmën e domosdoshme të shkencave të tjera.

Së pari elementet historiko-arkeologjik. Në një publikim të studiuesit Moikom Zeqo veçojmë: “Duke shfletuar një koleksion të gazetës “Illyria” të vitit 1935, pashë një shkrim profesional për arkeologjinë, botuar në datën 31 dhjetor 1935 dhe me vijim në datën 4 shkurt 1936 të një njeriu që nënshkruan Dr. Shyqyri Demiri. Titulli i shkrimit është “Arkeologjia dhe autoktoniteti i Ilyro-shqiptarëve”. Kam mbetur i befasuar kur e lexova, duke kuptuar se kisha të bëja me tekstin e një dijetari shqiptar i cili kishte fituar gradën shkencore Doktor në arkeologji”.

Ndër të tjera në këtë artikull të shumëvlerësuar nga autori theksohet fakti i rëndësishëm së madhe që kanë zbulimet arkeologjike dhe sidomos “Kultura e Komani” e cila hedh dritë mbi periudhën prehistorike të banorëve të Gadishullit të Ballkanit. Kështu mund të veçojmë nga ky artikull gjetjet që na interesojnë: “*Zbulime paleolithike mungojnë, po gjurmë kulturore dalin pikë së pari në fazën e fundshme neolithike. Konstatohen katër klasë të gjuetunash, ndër të cilat është edhe një thikë obsidiani që u gjet në Butrinto e me qenë se ky farë guri në Shqipëri nuk gjendet po në ishullin e Melos, duken kjashtas relacionet që kanë pasun banorët e këtushëm me vendet e largta të Mesdheut, qysh në kohët më të para (2500 p.Kr.). Në pikëpamje etnologjike kemi të bëjmë këtu me një popullsi paraindoeuropiane, si duket me Pelasgët. Në këtë kohë fillon invazioni i indogjerman që ishte një popull i math, i ndamun në shumë fise e dialekte. Më të përmendun nga këto fise ishin Grekët, Thrako-Ilirët e Italikët.*”⁷

Referuar shkrimit të mësipërm mendohet se të parët që erdhën në këto vise ishin grekët, pastaj italikët të cilët u hodhën matanë Adriatikut duke ua lënë kështu vendin thrakëve, e që këta të fundit u shtynë drejt mesit të gadishullit prej ilirëve. Citoj autorin: “*Kultura parahistorike (koha e hekurit me disa paraftaza) edhe pjesëmarrja në jetën provinciale, të perandorisë romane. Materiali i bronzit i dalun deri sot nga nëntoka shqiptare, përmban:*

⁶ E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqip*, f. 46, Tiranë, 2008.

⁷ “*Gazeta shqiptare*”, 15 shkurt 2013.

supata, supata dubel, supata me çekiç, etj., edhe koha që janë përdorun kto zgjatet nga 2200-1200 p.Kr.

Në Kohën e Hekurit, shkaktohet gjatë eksistencës së saj dasija kulturore e Shqipnís. Kurse në Shqipnin e Veriut zhvillohen të dy epokat e Kohës së Hekurit (Hallstatt e La Tene), merr Shqipnija e Mesme, ajo e Jugut e Maqedhonija krejt një zhvillim tjetër (me përjashtimin e enklavave greke: Lissos, Epidamnos, Orikum, Chimara, Panormus, Aulon, Onchesmus, Buthroton, Phoenica, Amantia, Byllis, Apollonia).

Ndër këto vise konstatohet një periudhë e parë e Kohës së Hekurit me karakter nordik edhe një kohë e vonshme, ku dominon influenca e madhe greke.”⁸

Pra flitet për një periudhë nordike që u shkri me elementin vendas: pellazgët, gjë që duhet të jetë pasqyruar në të gjithë zhvillimin shoqëror e kulturor. Kultura materiale na e provon këtë: elementet e theksuar më lart flasin për ndikime të ndërsjellta vendase (me gjasë pellazge) dhe ndikimin nordik.

Ajo që na intereson në këtë studim është elementi gjuhësor. Si dhe sa është ndier ky ndikim në gjuhë? Përgjigjet e vetme mund t'i gjejmë vetëm në toponiminë tonë, si pjesë e trashëgimisë sonë që ka mbetur dhe vazhdon të na përcillet edhe sot. Po si ka ndryshuar onomastika jonë? Si në të gjithë botën edhe në territorin tonë shumë toponime apo oronime e kanë origjinën në patronime. Kjo është lehtësisht e vërtetuar në toponiminë e kohës sonë. Këtu duhet të fillojmë të provojmë të kërkojmë edhe origjinën emrit “shqiptar”.

Ajo që na intereson është pikërisht prania elementeve nordike në trojet ilire në një periudhë shumë të hershme dhe kjo përligj edhe prezencën e fjalëve me rrënjë të përbashkët me gjuhët nordike. Nuk dihet se kur filloi të përdoret për herë të parë emri *shqiptar* për gjithë popullin shqiptar; në literaturë ndeshet për të parën herë në vitin 1766 tek Zmajçeviçi në veri dhe më 1774 te Thunmani në jug. Emrat e rinj u përgjithësuan që në fillim të shek. XIX dhe janë shprehje e zhvillimit kombëtar të popullit tonë.

Pse ky emër i lashtë mbeti i pazbuluar nga të tjerët. Duket se ky emër nuk përfshinte një popullsi të tërë, por vetëm një zonë të caktuar, që mund të ketë qenë popullsia veriperëndimore e Gadishullit Ballkanik, që vjen duke u zgjeruar, por jo aq sa të ndryshojë emrin e fisit, që tashmë paraqitet i institucionalizuar nga shteti shqiptar i Skënderbeut. Këta banorë në kushtet e vështira të pushtimeve romake u tërhoqën nëpër male, ku mund të punohej druri, por jo anijet duke e konservuar kështu këtë patronim.

Pse duhej të shfaqej në mesjetë ky emër? Pushtimi turk i Shqipërisë, mendoj, është faktori kryesor. Emri “arbër” u ruajt shumë jashtë trojeve tona dhe shumë më pak brenda kufijve tanë, siç ndodhi edhe me këngët e kujtimet e kohës së Skënderbeut. Për t'i shpëtuar terrorit osman ishte më komode

⁸ Po aty.

përdorimi i një emri tjetër sesa ai “arbër”. Prandaj edhe besoj u përhap shumë shpejt në këtë kohë.

Fakti që shfaqet si ndajfolje të Buzuku fjala *shqip* mendoj se lidhet pikërisht me praninë e kësaj fjale në këto fise ku edhe punoi e jetoi autori. Shtrirja edhe drejt jugut të vendit e këtij emri, mund të shpjegohet pikërisht me lëvizjet e popullsisë drejt jugut të vendit, pikërisht për shkak të pushtimit të vendit dhe terrorit osman.

Pra emri shqiptar lidhet me mjeshtërinë e punimit të drurit. Ky s’ka qenë asgjë më shumë vetëm një patronim. Po a nuk ishin anijet ilire të famshme për përsosmërinë e tyre? A mund të mohohet fama mbarëeuropiane e mjeshtërve ilirë të anijeve Pra emri *shqiptar* i ka rrënjët në aktivitetin e popullsisë që merrej me mjeshtërinë e ndërtimit të anijeve. Fjalët që përdoren për të treguar punim e drurit si gdhend apo latoj, punoj e ndërtoj janë të mëvonshme.

Hapësira ku u shfaq ky emër ka mundësi të jetë pikërisht Shqipëria Veriperendimore, jo vetëm ajo pjesë që gjendet sot në territorin shqiptar, por shumë më gjerë. Kjo zonë paraqitet e unifikuar si etnologjikisht edhe gjuhësisht dhe nga ana tjetër me tipare shumë dalluese nga pjesa tjetër e arealit verior. Prania e faktorit kulturor si shkollat, shtypshkronja e bibliotekat të drejtuara nga Vatikani janë një faktor i rëndësishëm që favorizoi shkrimin e gjuhës jo vetëm latine; por po të kemi parasysh epokën e Reformës edhe në gjuhën e popujve të krishterë. Mjafton të sjellim si shembull veprën e Buzukut për të cilën Robert Elsie thotë: “Gjuha e Buzukut paraqet tipare të gegërishtes veriperëndimore nga viset e bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, ndonëse në të takohen edhe elemente të dialekteve të tjera. Për historianët e gjuhës Buzuku është minierë të dhënash”⁹.

Faktorët gjeo-politikë duhet të kenë ndikuar në favorizimin e ruajtjes dhe përhapjes së emrit shqiptar përkundrejt emrave të tjerë si p.sh. dardan që ruhet edhe sot në trashëgiminë kulturore të banorëve të zonave verilindore. Për më tepër zonë veriperëndimore është banuar nga shumë fise ilire që duhet të pranonin një emër më gjithëpërfshirës siç ishte emri *shqiptar* që lidhej me punën kryesore të këtyre banove: përpunimin e drurit për anije. Pushtimet e njëpasnjëshme i kanë detyruar banorët e këtyre krahinave të zhvendosen drejt maleve por duke e marrë me vete bashkë me mjeshtërinë e punimit të drurit edhe emrin e mjeshtërisë së tyre.

Një faktor tjetër favorizues është ai historik, shumë i rëndësishëm sidomos pas vdekjes së Skënderbeut, kur banorët e qyteteve-kala dhe krahinave përreth që nga Shkodra e deri në Çamëri u larguan të tmerruar nga lufta dhe masakrat dhe u vendosën në Itali në jug e në veri të saj duke marrë me vete kulturën dhe krijimtarinë shpirtërore bashkë me emrin “arbër” i cili nuk mund të përdorej më në territorin e pushtuar nga turqit. Banorët që ribanuan vendin shumica

⁹ Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqipe*, Pejë, 2001, f. 36.

pasi u muslimanizuan kishin nevojë për një emër të ri që të ruanin identitetin e tyre kombëtar e të mos evidentoheshin si turq apo grekë. Emërtimi *shqiptar* zuri kështu vendin e lënë bosh nga arbër. Këtu ka shumë vend për studime onomastike ku i njëjti toponim na shfaqet në disa vende, gjë që mund të shpjegohet më lëvizjet e banorëve pas pushtimit turk.

Në këtë punim kemi fakte reale dhe hipoteza që mbështeten në këto fakte:

- Prania nordike në trevat shqiptare që vërtetohet në gjetje arkeologjike.
- Fjala *skei* që edhe pse dokumentohet si gjermanike mund të përafrohet me një fjalë shqipe e cila është konsideruar si fjalë ilire prej studiuesve të historisë së gjuhës.
- Ekzistenca e patronimit që si rrënjë ka pikërisht këtë fjalë *sche(p)* dhe prapashtesë tipike të gjuhës shqipe.
- Hapësira ku shfaqet ky patronim përkon me viset ku ka jetuar Buzuku ku për herë të parë shfaqet fjala *shqip*.
- Kjo hapësirë përkon me territoret ku dikur jetonin liburnët ndërtuesit më të njohur të anijeve me dru.

Shembulli tipik i asaj që ndodhte në trojet tona në fillim të mijëvjeçarit tonë, janë banorët e zonës së Shkrelit në Malësinë e Madhe. Ata u shpërngulën nga trojet e tyre në Bosnjën Qendrore dhe u zhvendosen në jug drejt Shqipërisë së Veriut, në shekullin XI-XII, gjatë sundimit të Stefan Nemanjës. Emrin Shkrel e gjejmë në trajtat *Schirelo*, *Scherelo*, *Shkripol* etj. Këta banorë, propaganda serbe përpiqet t'i paraqesë si popull sllav të shqiptarizuar, por vetë gjuha e tyre është pjesë e të folurës së Malësisë së Madhe, nëndialekti i gegërishtes veriore. Sipas studimeve të Franc Nopçës kjo krahinë është një terren i paeksploruar, ku ai e ka pasur të vështirë të realizojë studime të mirëfillta, por që mbart vlera të mëdha studimore. Edhe vetë emri i krahinës Schirel duhet kërkuar në të njëjtat rrënjë si edhe emri “shqiptar”.

Përfundime

Në bazë të arritjeve të studimeve arkeologjike dhe duke u nisur nga studimet gjuhësore vendase dhe të huaja mund të vërtetojmë origjinën shumë të hershme ilire të emrit “shqiptar”, një emër që lidhet me aftësinë e vërtetuar të banorëve të hershëm ilirë për të punuar drurin.

Fjala rrënjë e emrit shqiptar mund të kuptohet vetëm nëpërmjet shqipes, po kështu edhe zhvillimet fonetike dhe trajta morfologjike mund të përligjen nëpërmjet shqipes së sotme.

Pra kemi një emër të dokumentuar vonë, që ka ekzistuar si patronim shumë kohë para se të shkruhej dhe që i janë dashur mijëvjeçarë për të ardhur në trajtën e dokumentuar si i tillë në shekullin XVIII.

BIBLIOGRAFI

“Gazeta shqiptare”, *Emrat nacionalë të shqiptarëve*, 15 Shkurt 2013.

Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, “Maluka” Tiranë, 2002.

E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqip*, f. 46, Tiranë, 2008.

K. Topalli, *Bazat e fonetikës historike të gjuhës shqipe*, SHBLSH, Tiranë 2005.

K. Topalli, *Dukuritë fonetike të sistemit të bashkëtingëlloreve të gjuhës shqipe*, “Mësonjëtorja” Tiranë, 2004.

Online, Etymology Dictionary www.etymonline.com

Revista: “Shqipëria e re”, Nr. 1, 1972, Viti XXVI.

Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqipe*, Pejë, 2001.

